

## Florian Vlashi



Ka lindur ne Durres me 8 Nentor 1963. Fillon studimet e violines ne moshen 6 vjeçare. I jati i tij Gjergj Vlashi, shkrimtar dhe rregjizor teatri mjaft i njohur, luajti nje rrol deçiziv ne te ardhmen e te birit. Studion me V.Papa, R. Stefi, I Madhi dhe fiton vendin e pare me unanimitet te zhurise ne Akademe e Arteve te Bukura te Tiranes. Ne 1989 fiton Çmimin e Pare ne Konkursin e Solistave dhe Orkestrave Sinfonike te Shqiperise. Ne kete vit krijon Orkestren e Harqeve “Jan Kukuzeli”me te cilen realizon mjaft koncerte, incizime per RTVSH si dhe turneun e pare te koncerteve ne Itali ( 1992 ). Qe nga 1992, pas fitimit te Konkusrit ne Shtutgart eshte anetar i Orkestres Sinfonike te Galicise ( Spanje ), perfeksionohet me G. Egger ( Bachakademi Stuttgart ) dhe me L. Müller ( koncertmaester i Orkestres se Dhomes se Vienes ). Aktivitetet e tij shtrihen dhe ne pedagogji, konferenca ne Universitetin e Rioja dhe La Coruña ( Spanje ) dhe publikime mbi estetikën interpretative . Eshte ftuar te luaj ne inagurimin e sezonit te koncerteve ne Centro de Arte Moderno REINA SOFIA, Fundación JUAN MARCH, Aditario Nacional de Musica ne Madrid, ne CAIM – Salamanca, ne Akademe e Spanjes ne Rome, Instituti Cervantes ne Napoli, ne Festivalin e Verones, ne Zvicër, ne Ameriken Latine si Brazil e Uruguaj, Remusica ( Prishtine), en zdzn Odessa etj. si dhe ne Festalet kryesore te Muzikes ne Spanje. Bashkepunon si solist me Plural Ensemble de Madrid. Kompozitoret E. Buharaja, C. Lopez Garcia, J. Vara, X de Paz, P. Perreiro, M. D. Malumbres, J. Durán, A. Koci, H. Palma, W. Rosinskij i kane dedikuar vepra te tyre. Ne 1999 doli ne shitje CD e tij “Andres Gaos- Integral per violin e piano” dhe eshte ne botim CD dedikuar Stravinskit. Ne Qershor te po atij viti televizioni shqiptar i dedikoi dokumentarin “Florian Vlashi – violina shqiptare ne Spanje”. Qe nga viti 2003 drejton Bienalen Netet e Muzikes Klasike – Durres Asociación Gallega de Compositores e ka zgjedhur “Socio protector” Ne 1996 drejton formacionet Paganini Ensemble, Camerata Brigantina - Orkestra e te Rinjve – Betanzos) si dhe Grupo Instrumental SIGLO XX te perbere nga solistet e Orkestres Sinfonike te Galicise nga me se 10 vende te ndryshme te botes, duke luajtur nder te tjera per here te pare 90 vepra te autoreve spanjolle e te huaj dhe ka ne repertor mbi 200 vepra. Koncertet e tij jane transmetuar nga Radio Nacional de España, nga TVE 2 dhe nga Kanali Nderkombetar Satelitor i Spanjes. Nga kritika e specializuar eshte vleresuar si nje nga tre formacionet me te mira te Spanjes. Florian Vlashi luan me nje violine franceze te shekullit XVIII te J. Bocquay.

- Kane shkruar per te :
- “ Me talentin e kulturen e gjere qe zoteron, jep nje imazh te vertete te shpirtit te shqiptarit, qe mbijetoi permes dictatures e indiferences europiana. Me personalitetin e tij mundohet te zhbeje ate qe bene ne 50 vjet tere ambasadoret socialist te Shqiperise, te davarise sado pak ate perde erresire qe kane hedhur mbi Shqiperine” Pirro Dollani
- “ Ju jeni shqiptari i dyte qe kam takuar ne jeten time pas Nene Terezes” Zubin Mehta, dirigjent
- “ Vlashi luan me shume elegance, zhdervjelltesi teknike e musikalitet. Loja e tij eshte thjeshte mjeshtrore . Nje artist i shkelqyer” Romiro Cartelle , kritik muzikor
- “ Florian Vlashi , nje tjetër shqiptar qe i ben nder kombit “ Gezim Kabashi, gazetar
- “ Peneli i arte ishte koncerti i Florian Vlashit, interpretim i shkelqyeshem, plot virtuoze, dominim e asimilim te muzikes moderne”. Carlos Blanco Ruiz , Kritik muzike
- “ Muzika klasike e re triumfon ne duart e Vlashit” O. Castro, kritik muzike
- “ Vlashi eshte nje muzikant i kategorise se larte. Ishte nje koncert vertet i mahnitshem “ Enrique Sacou , kritik
- “ Vlashi ka te rralla jo vetem cilesite si instrumentist por dhe ato njerezore. Eshte kenaqesi ta keshe prane edhe si muzikant edhe si njeri” Juan Duran , compositor
- “ Pa te muzika moderne ne Galici nuk do te ishte ajo qe eshte. Nje person qe beson ne muziken e re e ne kompozitoren e vendit tone” Paulino Pereiro , compositor nga dedikimi i sonates “ Vlashiana “
- “ Te pranishmit e kesaj nate ishin fatlume qe paten rastin te shijonin nga afer nje nga instrumentistet me te mire te epokes sone” Metila Dervishi, muzikologe
- “Nje violinist i jashtezakonshem” Miguel Anxo Fernan Vello, poet
- “ Bagazhi artistik e ben Vlashin nje nga protagonistet me te medhenj te muzikes se re ne Galici – Spanje ne keto dekadat e fundit. ...Ka ne interpretimin e tij nje ekzekutim teknik te larte me nje ekspresivitet e ndjenje teper te pershtatshme. Gishtat e tij jane te perkryer ne pasazhet me virtuoze qe i perballon me nje natyrshmeri te habitshme. Teknikisht loja e Vlashit me duket verbuese.”
- Paco Yáñez , muzikolog
- ( Per me shume vizitoni [www.grupoinstrumentalsigloxx.com](http://www.grupoinstrumentalsigloxx.com) )